



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 605 Akti**

**Nr. 760 Vendimi**  
**Tiranë, më 26.4.2024**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	Kryesuese
<b>Xhensila Pine</b>	Relatore
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 24.4.2024, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Ardiana Bera**, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

1. Znj. Ardiana Bera është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Ardiana Bera i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine (relatore).
3. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore ndihmëse të procesit, kreu hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Alma Faskaj dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Ardiana Bera bazuar në të tre kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi barrën e provës mbi rezultatet e hetimit referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën e saj për dhënien e shpjegimeve e provave, thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Subjekti paraqiti provat dhe shpjegimet në përgjigje të barrës së provës brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni.

## **I. SEANCA DËGJIMORE**

7. Në datën 24.4.2024, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vijuar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 26.4.2024, ora 09:45.

## **II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

8. Subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi ka vlerësuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

10. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 e nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

10.1 Nga analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, analizimi i materialeve shkresore të administruara dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit

administrativ të kryer nga Komisioni për pasuri të subjektit/personit të lidhur, ka rezultuar si vijon:

## **11. Apartament me sipërfaqe totale 136.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë**

**11.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar në vitet 2002 – 2011, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.9.2011, në shumën 6.000.000 lekë, në pjesë takuese 50%.

**11.2** Burimi i krijimit i deklaruar: shitja e banesës në qytetin e Krujës me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.9.1999, nga kursimet familjare në vite të familjes së bashkëshortit; të ardhurat nga puna e subjektit deklarues dhe bashkëshortit; kursimet familjare dhe ndihma e familjarëve të subjektit të deklaruar në vite.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**11.3** Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.9.2011, në shumën 6.000.000 lekë.

**11.4** Në deklaratën për herë të parë dorëzuar në ILDKPKI në datën 18.3.2004, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi në Tiranë, blerë me kontratë sipërmarrjeje datë 16.3.2002, në çmimin 6.000.000 lekë. Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 2 milionë lekë.

**11.5** Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2004, subjekti ka deklaruar dhe saktësuar lidhur me pagesat e kryera për këtë pasuri duke specifikuar se i ka paguar shoqërisë ndërtuese në vitin 2003 vlerën 2 milionë lekë, në vitin 2004 vlerën 3 milionë lekë dhe i mbetet pa paguar vlera 1 milion lekë, e cila do paguhet me marrjen e vërtetimit të pronësisë. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në shumën 3.000.000 lekë për pagesat e kryera në këtë vit.

**11.6** Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit, në ndryshim të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ka deklaruar se është hartuar për këtë pasuri kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.9.2011 dhe është regjistruar pasuria.

**11.7** Nga analizimi i parashikimeve ligjore të kontratës së sipërmarrjes, kontratë, e lidhur në datën 16.3.2002 me shkresë të thjeshtë ndërmjet sipërmarrësit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositëses Ardiana Bera, palët kanë dakordësuar porositjen e apartamentit me sip. 136.7 m<sup>2</sup>, duke dakordësuar si çmim të kësaj kontrate vlerën 54.600 USD dhe duke deklaruar se vlera 30.000 USD do paguhej me lidhjen e kontratës ndërsa pjesa tjetër me mbarimin e punimeve.

**11.8** Nga analizimi i parashikimeve ligjore të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur mes palëve në datën 23.9.2011, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. kanë deklaruar se kanë realizuar shitjen e kësaj pasurie të paluajtshme kundrejt çmimit 6.000.000 lekë, pagesë kjo e kryer sipas mandateve të mëposhtme:

- nr. \*\*\*, datë 16.3.2002, në shumën 14.300 USD;
- nr. \*\*\*, datë 22.1.2004, në shumën 2.000.000 lekë;
- nr. \*\*\*, datë 15.12.2004, në shumën 1.000.000 lekë;
- nr. \*\*\*, datë 23.11.2005, në shumën 10.000 USD.

**11.9** Në përgjigje të pyetësorit të datës 29.9.2023, subjekti, në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit të blerjes dhe kohën e pagesës ka deklaruar se: *“Banesa është blerë me pagesë me këste (me mandatpagesë pranë arkës së firmës): në datën 16.3.2002 është paguar shuma 14.300 USD (2 milionë lekë); në muajin janar 2004 është paguar shuma prej 2.000.000 lekësh; në muajin dhjetor 2004 është paguar shuma prej 1.000.000 lekësh; në muajin nëntor 2005 është paguar shuma 10.000 USD”*.

**11.10** Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se me kontratën e sipërmarrjes së datës 6.8.2001 bashkëshorti A. H. kishte porositur një apartament tjetër të njëjta shoqëri ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila ishte anuluar me dëshirën dhe vullnetin e palëve në datën 1.10.2002 në zyrat e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. duke u kthyer personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, dhe vlera e paguar prej tij prej 20.000 USD, sipas mandatpagesës së datës 1.10.2002.

**11.11** Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pas kërkesës së Komisionit, ka vënë në dispozicion praktikën e kontratës së shitblerjes dhe asaj të sipërmarrjes së lidhur midis saj dhe porositëses Ardiana Bera në selinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për një apartament me sip. 136.7 m<sup>2</sup>, duke shpjeguar se me vullnetin e palëve vlera e pasurisë është dakordësuar 6.000.000 lekë dhe këstet e pagesave janë bërë në arkën e shoqërisë nga klientja Ardiana Bera me mandatarkëtimet e referuara në pikën 11.8 të këtij vendimi.

**11.12** Komisioni gjithashtu kërkoi informacion dhe hetoi për raste të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për konflikt interesi për subjektin e rivlerësimit.

**11.13** Për sa nga hetimi u konstatuan mospërputhje midis kontratës së sipërmarrjes dhe të shitblerjes, nënshkruar mes palëve, për sa i përket çmimit të kësaj pasurie dhe modaliteteve të pagesës, Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur në rezultatet e hetimit edhe sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes të nënshkruar mes palëve dhe sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes të nënshkruar mes palëve.

#### **Lidhur me burimin e deklaruar dhe mundësinë financiare**

*a) Shuma e përfituar nga shitja e apartamentit 3+1 në qytetin e Krujës*

**11.14** Në deklaratën *Vetting*, në seksionin “Deklarimi i pasurive”, subjekti ka pasqyruar si burim të ardhurat nga kontrata e shitjes datë 13.9.1999, e apartamentit të personit të lidhur dhe prindërve të tij, në qytetin e Krujës.

**11.15** Në deklaratën për herë të parë dorëzuar në ILDKPKI në datën 18.3.2004, subjekti gjithashtu ka deklaruar si burim krijimi për apartamentin objekt hetimi, të ardhurat nga shitja e banesës në qytetin e Krujës në vlerën 2.000.000 lekë.

**11.16** Në analizë të parashikimeve ligjore të kontratës së shitjes të apartamentit në qytetin e Krujës të datës 13.9.1999 rezultoi se personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) dhe prindërit e tij kanë shitur apartamentin me sip. 89.62 m<sup>2</sup> në qytetin e Krujës kundrejt shumës 1.500.000 lekë.

**11.17** Komisioni vlerësoi që në analizën financiare të kryer me rezultatet e hetimit të merret në konsideratë si burim krijimi për pasurinë objekt hetimi vetëm shuma 500.000 lekë, e cila i përket pjesës takuese të bashkëshortit të subjektit në kontratën e shitjes së datës 13.9.1999.

*b) Shuma e përfituar nga huamarrja e deklaruar nga vëllezërit e subjektit*

**11.18** Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për apartamentin objekt hetimi ndihmën nga familjarët dhe në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar shumën 2.000.000 lekë, të marrë hua pa kontratë nga vëllezërit e saj.

**11.19** Subjekti ka deklaruar se nga kjo hua prej 1.000.000 lekësh nga familjarët e saj në vijim iu bë dhuratë vajzës së saj, ndërsa shuma 1.000.000 lekë u shlye si rezultat i kursimeve familjare të deklaruara, kursimeve nga paga të subjektit dhe bashkëshortit.

**11.20** Me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.8.2019, vëllezërit M. dhe I. B. kanë deklaruar se: “Në vitin 2002 i kemi dhënë hua motrës sonë, shtetases Ardiana Bera, shumën prej 2.000.000 lekësh, shumë të cilën e kemi sjellë dhe dërguar me persona të ndryshëm të familja jonë në Krujë. Burimi i krijimit të kësaj shume janë kursimet nga të ardhurat e emigracionit në shtetin anglez...”.

**11.21** Komisioni vlerësoi të analizojë burimin e të ardhurave të vëllezërve për shumën 2.000.000 lekë, të dhëna hua, në vlerësim të faktit se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, që kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, në këtë rast likuiditeteve të dhëna hua.

**11.22** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *“Me gjithë kërkimet e bëra nga vëllezërit e mi, nuk është bërë e mundur gjetja e dokumenteve (listëpagesa) në shtetin anglez për periudhën 1998 – 2002, për shkak të kalimit të një afati të gjatë kohor...”*.

**11.23** Subjekti ka depozituar dokument të datës 20.1.2020, lëshuar nga \*\*\* në gjuhën angleze (i pajisur me vulë apostile), i përkthyer në gjuhën shqipe, ku pasqyrohet fakti se shtetasi I. B. ka qenë i punësuar në \*\*\* Ltd... që prej tetorit 1999 deri në gusht 2004.

**11.24** Subjekti ka depozituar gjithashtu shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Durrës, ku informohet se shtetasi M. B. ka hyrë në pikën e kalimit kufitar port Durrës në datën 9.7.2000, me linjën e udhëtimit Bari-Durrës.

**11.25** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar lidhur me të ardhurat dokument në gjuhën angleze (i pajisur me vulë apostile) dhe i përkthyer, lëshuar nga zyra \*\*\* për shtetasin I. B., si dhe dokumentacionin bankar të tij, por këto dokumente ligjore provuese referojnë një periudhë kohore që daton pas dhënies së huas subjektit të rivlerësimit në mars të vitit 2002.

**11.26** Gjithashtu, subjekti ka bashkëlidhur deklaratat tatimore në gjuhën angleze me vulë apostile dhe të përkthyer në gjuhën shqipe (të dorëzuara në formën e kërkuar nga ligji); llogaritja e taksave për vitet 2004 – 2005, 2005 – 2006, 2006 – 2007, 2007 – 2008 dhe 2008 – 2009 për shtetasin I. B.; llogaritja e taksave për vitet 2004 – 2005, 2005 – 2006 dhe 2006 – 2007 për shtetasin M. B., por edhe këto dokumente ligjore provuese referojnë periudhën kohore që daton pas dhënies së huas subjektit të rivlerësimit në mars të vitit 2002.

**11.27** Sa më sipër, nga Komisioni u vlerësua se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave të vëllezërve të saj (persona të tjerë të lidhur) për dhënien e shumës 2.000.000 lekë në mars të vitit 2002, pasi informacioni i plotë i shoqëruar me dokumentacion ligjor për burimin e të ardhurave të tyre fillonte pas dhënies së huas. Për sa më sipër arsyetuar u vlerësua të mos merret në konsideratë si burim krijimi i pasurisë objekt hetimi shuma prej 2.000.000 lekësh, deklaruar hua nga vëllezërit në analizën financiare të përgatitur me rezultatet e hetimit për subjektin.

*c) Të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortit, kursime familjare*

**11.28** Komisioni analizoi burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti e personi i lidhur, të ardhurat nga paga, për pagimin e pasurisë objekt hetimi.

**11.29** Në bazë të dokumentacionit të administruar nga Komisioni rezultoi se:

- Të ardhurat nga marrëdhënia e punësimit të subjektit për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003 janë në vlerën neto prej 4.278.812 lekësh.

- Të ardhurat nga marrëdhënia e punësimit të personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) për periudhën shkurt 1993 – 2003 janë në vlerën neto prej 1.857.348 lekësh.

**11.30** Komisioni analizoi dhe kursimet *cash* të deklaruara si burim krijimi për këtë apartament, deklaruar edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 15.1. 2015, ku subjekti ka deklaruar si burim krijimi *të gjitha kursimet familjare nga viti 1991 të saj si subjekt, bashkëshortit të saj dhe familjarëve të bashkëshortit.*

**11.31** Në lidhje me të ardhurat nga prindërit e bashkëshortit, referuar dokumentacionit, rezulton se babai i bashkëshortit është trajtuar me pension pleqërie dhe për periudhën e vlerësuar nga Komisioni se ka jetuar me subjektin dhe personin e lidhur me të, respektivisht qershor 1995 – shtator 1999 ka përfutur shumën 185.720 lekë, ndërsa nëna e bashkëshortit është trajtuar me

pension pleqërie dhe për periudhën qershor 1995 – shtator 1999 ka përfituar shumën 185.540 lekë.

**11.32** Në lidhje me të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga familja e bashkëshortit, krijuar nga bujqësia/blegtoria, Komisioni ka vlerësuar se ato mbeten vetëm në nivel deklarativ si për ushtrimin e këtij aktiviteti, shuma e të ardhurave të përfituara, edhe për shlyerjen e detyrimeve përkatëse tatimore në zbatim të legjislacionit përkatës, duke mos u marrë në konsideratë në rezultatet e hetimit administrativ.

**11.33** Sa më sipër, Komisioni vlerësoi që të përfshihen në analizë financiare të ardhurat e dokumentuara të subjektit dhe bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga pensioni të prindërve të bashkëshortit vetëm për periudhën qershor 1995 – shtator 1999, duke përfshirë edhe shpenzimet përkatëse për jetesë mbi familjen referuar numrit të personave.

### Analiza financiare

**11.34** Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për të paguar pasurinë e paluajtshme objekt hetimi administrativ, duke konsideruar në këtë analizë financiare të kryer për shkak të mospërputhjeve në dokumentacionin ligjor edhe kontratën e sipërmarrjes dhe kontratën e shitblerjes, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë.

### Lidhur me pagesat e kryera për shoqërinë ndërtuese në vitin 2002

**11.35** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të pagimit të kësteve të apartamentit në vitin 2002 sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatarëkëtimit, për vitin 2002 sipas tabelës vijuese.

**Tabela nr. 1**

<b>Analiza e treguesve financiarë për periudhën shtator 1991 – 16 mars 2002, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pagesën e kështit të parë të apartamentit</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit në Prokurorinë e Rrethit Krujë, për periudhën shtator 1991 – shtator 1997	1009953
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit në Gjykatën e Rrethit Krujë, për periudhën tetor 1997 – mars 2002	2159634
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit si p. policie DVP Durrës, për periudhën shkurt 1993 – 15.11.1997	598831
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Krujë për periudhën nëntor 1997 – maj 2000	919212
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Tropojë, për periudhën maj 2000 – janar 2001	339305
Të ardhurat neto nga shitja e apartamentit në Krujë në vitin 1999	<b>487160</b>
Të ardhurat nga huaja e deklaruar, marrë nga vëllezërit e subjektit në vitin 2002	0
Të ardhurat nga pensioni i babait të bashkëshortit për periudhën qershor 1995 – shtator 1999	185720
Të ardhurat nga pensioni i nënës së bashkëshortit për periudhën qershor 1995 – shtator 1999	185540
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>5885355</b>
Shpenzim për pagesë të kështit të apartamentit në shumën 14.300 USD, në datën 16.3.2002	2023021
Shpenzim për pagesë të kështit të apartamentit nga bashkëshorti në datën 6.8.2001, në shumën 20.000 USD	2878000
Shpenzime minimale për konsum sipas jurisprudencës së Kolegjit, për periudhën 1991 – 1999	1087247
Shpenzime minimale për konsum sipas ILDKPKI-së për periudhën 2000 – 16.3.2002, për 2 persona	441788
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>6430056</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0

Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-544701</b>

**11.36** Sa më sipër duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, duke rezultuar me balancë negative për këtë periudhë në vlerën -544.701 lekë.

**11.36.1** Referuar analizës së kryer sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes hartuar mes palëve, nga e cila rezultoi se për subjektin dhe personin e lidhur kishte pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën.

**11.37** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit referuar analizave financiare të kryera sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes dhe sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes rezultuan me pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën.

#### **Lidhur me pagesat e kryera për shoqërinë ndërtuese në vitin 2004**

**11.38** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 pakësim të gjendjes *cash* gjatë vitit 2004 në shumën 3.000.000 lekë për pagesën e detyrimit të shoqërisë ndërtimore.

**11.39** Komisioni kreu analizën e gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti në deklaratën për herë të parë dorëzuar në ILDKPKI në datën 18.3.2004, për sa burimi i deklaruar për shlyerjen e shumës 3.000.000 lekë në vitin 2004 referonte gjendjen *cash* në fund të vitit 2003, për të cilën duket se nuk u arrit të dokumentohej plotësisht nga subjekti ligjshmëria e burimit të saj, duke rezultuar me pamundësi financiare për krijimin e saj në fund të vitit 2003, në vlerën -2.643.472 lekë.

**11.40** Në vijim të arsyetimeve të mësipërme u krye analiza financiare për vitin 2004 për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit lidhur me pagesat e kryera për shoqërinë ndërtuese në vitin 2004, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara në këtë vit.

**11.40.1** Mbështetur në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, u vlerësua se vetëm kursimet e mundshme *cash*, të cilat provohen për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit tyre duhet të llogariten si burime financimi për pasuritë, investimet dhe/ose shpenzimet, likuiditete që subjekti i ka deklaruar si burim krijimi.

**11.40.2** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të pagimit të kësteve të apartamentit në vitin 2004 sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatarkëtimeve, për vitin 2004 sipas tabelës vijuese.

**Tabela nr. 2**

<b>Analiza e treguesve financiarë për vitin 2004, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pagesën e kësteve të apartamentit sipas kontratës së shitblerjes</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit për periudhën	878986
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit për periudhën	621926
Të ardhurat nga zbatimi i vendimit gjyqësor nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ekzekutuar në datën 30.9.2004	1048798
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>2549710</b>
Shpenzim pagesë shoqërisë ndërtuese	3000000
Shpenzim pagesë për blerje garazhi, shuma 10.000 euro, në datën 25.11.2004	1263500
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	151620
Shpenzime udhëtimi/transport i brendshëm (deklaruar në pyetësorin nr. 2), llogaritur	100320

Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën, 2 persona	187928
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>4703368</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	1977478
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-176180</b>

**11.41** Sa më sipër duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, duke rezultuar me balancë negative për vitin 2004 në vlerën -176.180 lekë.

**11.42** Referuar analizës së kryer sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes hartuar mes palëve, nga e cila rezultoi se për subjektin dhe personin e lidhur kishte pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën.

**11.43** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit referuar analizave financiare të kryera sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes dhe sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes rezultuan me pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2004.

### **Lidhur me pagesat e kryera për shoqërinë ndërtuese në vitin 2005**

**11.44** Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Paguar me kursimet nga paga dhe kursimet e mbartura, shuma 10.000 USD minus 600.000 lekë”*. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2023, ka vënë në dispozicion edhe mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 23.11.2005, në shumën 10.000 USD.

**11.45** Nisur nga fakti që në deklaratën e interesave privatë për vitin 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, me kontratën e datës 21.3.2005, Komisioni, vlerësoi kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse mbi gjithë pasuritë e krijuara në vitin 2005.

**11.46** Referuar informacionit nga DPSHTRR-ja rezulton se automjeti tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\*, prodhim i vitit 1994 është blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj me kontratë në datën 21.3.2005 kundrejt shumës 300.000 lekë. Nga hetimi rezultoi se shitësi e ka blerë këtë automjet me kontratën nr. \*\*\*, datë 28.1.2005, në shumën 200.000 lekë dhe ka shlyer detyrimet doganore në shumën 218.750 lekë, duke shpenzuar në total shumën 418.750 lekë.

**11.47** Nisur nga shpenzimet për blerjen dhe zhdoganimin e këtij mjeti nga shitësi në vlerën 418.750 lekë dhe për sa subjekti dhe personi i lidhur e blejnë këtë mjet, duke specifikuar se *“blerësi e ka marrë në dorëzim këtë mjet në gjendje të mirë teknike”*, Komisioni vlerësoi të pasqyrojë në analizën financiare të subjektit/personit të lidhur shumën 418.750 lekë si vlerë blerje në vitin 2005.

**11.47.1** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të pagimit të këstit të apartamentit në vitin 2005 sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatit përkatës për vitin 2005, sipas tabelës vijuese.

**Tabela nr. 3**

<b>Analiza e treguesve financiarë për vitin 2005, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pagesën e kësteve të apartamentit në këtë vit</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit për periudhën	996584
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit për periudhën	654593
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>1651177</b>



Shpenzim për pagesë shoqërisë ndërtuese	1035800
Shpenzim për blerje automjeti tip “***”, llogaritur	418750
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	147096
Shpenzime udhëtimi/transport i brendshëm (deklaruar në pyetësoin nr. 2), llogaritur	62700
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën, 2 persona	219114
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>1883460</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-482785
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-715068</b>

**11.48** Referuar analizës financiare të mësipërme, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2005, duke rezultuar me balancë negative për periudhën, në vlerën -715.068 lekë.

**11.49** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit referuar analizës financiare ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërputhjet e konstatuara**

**11.50** Subjekti në shpjegimet e paraqitura pas kalimit të barrës së provës ka kërkuar të merren në konsideratë deklaratimet e saj në deklaratën *Vetting* dhe në ato lidhur me pagesat e kryera, duke deklaruar se: *“Deklaratat e mia periodike pranë ILDKPKI-së pasqyrojnë saktë pagesat e mia lidhur me pasurinë dhe përputhen me përgjigjen e dhënë nga shoqëria sipërmarrëse.*

*Nga analizimi i deklaratimeve të mia periodike më duhet të pranoj që ka nja pasaktësi në deklaratim dhe kjo lidhet me deklaratën e parë, datë 18.3.2004. Arsyeja e deklaratimit të detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. në shumën 2 milionë lekë është detyrimi i mbetur në momentin e deklaratimit. Deklarimi im është kryer datë 18.3.2004 dhe pagesat e mia lidhur me apartamentin sipas edhe mandatpagesave të depozituara nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ishin në shumën 4.000.000 lekë në momentin e plotësimit të deklaratës”.*

**11.51** Subjekti ka kërkuar të merren në konsideratë parashikimet e kontratës së shitblerjes, duke parashtruar se *kontrata e sipërmarrjes është një dokument që lidh dhe orienton palët në kryerjen e pagesave, për më shumë kontratat e sipërmarrjes të lidhura me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. janë të një formati të thjeshtë, më shumë orientues sesa detyrues. Në këto kontrata nuk ka as detyrime, as penalitete për mospagimin në kohë të kësteve të pagesës.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me mundësinë financiare**

**11.52** Subjekti ka kërkuar të përfshihet në analizën financiare si vijon:

**11.52.1** Lidhur me analizën financiare, ajo duhet të bëhet në përputhje me deklaratimet periodike dhe dokumentacionin e disponuar, duke përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Krujës, si burim financiar i deklaruar që në deklaratën e parë pranë ILDKPIK-së dhe vazhdimisht si burim për krijimin e pasurisë, mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2003 dhe përfshirjen e huas së marrë nga vëllezërit e saj, duke kërkuar të merren në konsideratë dispozitat ligjore të nenit 32, pikat 2, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për pamundësinë objektive të sigurimit të informacionit të kërkuar.

**11.52.2** Lidhur me analizën financiare për vitin 2005, subjekti ka pretenduar se në të nuk është evidentuar sa shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka kthyer shumën 600.000 lekë, deklaruar prej saj edhe në deklaratimin periodik për punimet e kryera në periudhën 2003 – shkurt 2004, shumë e cila është

përfshirë si shpenzim në analizën e kryer nga Komisioni për periudhën deri në dhjetor të vitit 2003.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**11.53** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton se:

### **Lidhur me mospërputhjet në dokumentacionin ligjor**

**11.54** Trupi gjykues ka vlerësuar të analizojë së pari në këtë vendim mospërputhjet e konstatuara mes kontratës së sipërmarrjes dhe të shitblerjes, nënshkruar nga subjekti dhe shoqëria ndërtuese.

**11.54.1** Pikat 1, 2 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaratimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të pasurisë dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet origjina, veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, si dhe mjetet financiare për krijimin e saj.

**11.55** Analiza e mospërputhjeve të konstatuara në kontratat e nënshkruara nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie për sa i përket vlerës dhe modaliteteve të pagesës u krye nga Komisioni, duke u vlerësuar nëse në thelb të këtyre veprimeve gjendeshin elemente që përfaqësonin përpjekje të subjektit për të justifikuar pasuri të fituara me burime të paligjshme apo për të justifikuar mungesë burimesh të ligjshme, fshehje të pasurive apo deklarime të rreme.

**11.56** Komisioni vlerëson se këto mospërputhje në dokumentacionin ligjor të hartuar mes palëve nuk kanë afektuar deklarinin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe nuk kanë pasur për qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarinin e pasaktë të të dhënave të kësaj pasurie në këtë deklaratë dhe nuk kanë afektuar me paligjshmëri burimin e krijimit të pasurisë objekt hetimi.

**11.57** Për sa më sipër, mospërputhjet në dokumentacionin ligjor për përfitimin e pasurisë së paluajtshme objekt deklarimi në deklaratën *Vetting* janë vlerësuar nga trupi gjykues si pasaktësi në veprimin e ligjshëm, që passjell disponimin e kësaj pasurie nga subjekti.

**11.58** Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarinin e pasaktë të të dhënave.

**11.59** Trupi gjykues analizoi përmbajtjen e kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të shitblerjes, nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese, dhe interpretoi të dhënat e deklaruara në to sipas rregullave të nenit 681 e vijues të Kodit Civil në raport me sjelljen e palëve gjatë dhe para lidhjes së tyre dhe në një vlerësim të harmonizuar të të gjitha rrethanave që kanë dalë nga hetimi i çështjes.

**11.60** Trupi gjykues ka kryer analizën e mospërputhjeve në dokumentacionin ligjor të nënshkruar nga subjekti për përfitimin e kësaj pasurie të paluajtshme, duke mbajtur në konsideratë, por jo vetëm, rrethanat si vijon: (i) qëndrueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me çmimin prej 6.000.000 lekësh dhe mënyrën e shlyerjes së kësaj vlere, deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë dhe korrigjimin e bërë nga subjekti në deklarimin periodik të vitit 2004; (ii) konfirmimin për vlerën e këtij çmimi të deklaruar prej shoqërisë

ndërtuese; (iii) konsiderimin e faktorit kohë të kryerjes së veprimeve në mungesë të ndonjë parashikimi ligjor, që përcaktonte detyrime eksplicite për subjektin e rivlerësimit për zbatimin e kontratës së sipërmarrjes; (iv) faktin që në nënshkrimin e kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.9.2011, subjekti i rivlerësimit dhe shitësi i kanë veshur veprimet formën e kërkuar ligjore, duke e përpiluar përpara noterit dhe nënshkruar para tij në referim të parashikimeve të Kodit Civil, ku përcaktohet se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët dhe përbën provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”*.

**11.61** Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues ka vlerësuar se dokumenti ligjor i cili duhet të merret në konsideratë në analizën përfundimtare financiare për mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur për pagimin e vlerës së kësaj pasurie duhet të jetë kontrata e shitblerjes e nënshkruar mes palëve, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.9.2011, për sa i përket vlerës dhe modaliteteve të kryerjes së pagesave, mandateve përkatëse lidhur me pagesat për këtë pasuri të paluajtshme.

**11.62** Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë gjithashtu se nuk u provua asnjë veprim apo përpjekje e subjektit për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave lidhur me këtë pasuri.

### **Lidhur me mundësinë financiare**

**11.63** Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, arsyeton se:

*Lidhur me pagesën e kryer në vitin 2002*

**11.64** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me shumën e të ardhurave të përfituara nga subjekti dhe personi i lidhur nga shitja e apartamentit në qytetin e Krujës, arsyeton se deklaratimet e dhëna nga subjekti lidhur me përdorimin e të gjithë çmimit të shitjes së pasurisë në qytetin e Krujës nga familja e bashkëshortit si burim krijimi për këtë pasuri konsiderohen të besueshme.

**11.65** Në bazë të kontratës së shitblerjes datë 13.9.1999, bashkëshortit të subjektit, dhe prindërit e tiji kanë shitur apartamentin me sip. 89.62 m<sup>2</sup> në qytetin e Krujës kundrejt shumës 1.500.000 lekë.

**11.66** Në referim të sa subjekti ka deklaruar në vazhdimësi nga deklarimi për herë të parë e deri në deklaratën *Vetting*, se vlera e shitjes së pasurisë së bashkëshortit në bashkëpronësi me prindërit ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë situatën faktike, si dhe të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej saj në aspektin logjik lidhur me përdorimin e të gjitha të ardhurave të krijuara nga shitja e kësaj pasurie si burim për blerjen e apartamentit objekt hetimi. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe mungesën e investimeve mbi pasuri të tjera të paluajtshme apo të luajtshme nga prindërit e bashkëshortit pas shitjes së këtij apartamenti të ndodhur në qytetin e Krujës, fakt ky i provuar nga hetimi administrativ i kryer për ta.

**11.67** Referuar dokumentacionin ligjor kontratës të shitjes së apartamentit në qytetin e Krujës ka rezultuar se të ardhurat e përfituara nga shitja kanë qenë në vlerën 1.500.000 lekë, vlerë kjo për të cilën provohet pagimi i detyrimeve tatimore dhe regjistrimi i pasurisë në emër të blerësit, ndaj kjo vlerë u vlerësua të pasqyrohet në analizën financiare të subjektit e personit të lidhur dhe të konsiderohet si burim krijimi për apartamentin objekt i këtij hetimi.

**11.68** Pas marrjes në konsideratë në analizën financiare përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur vetëm të vlerës 1.500.000 lekë, sipas arsyetimit të mësipërm, analiza financiare përfundimtare e treguesve financiarë për periudhën shtator 1991 – 16.3.2002 do të rezultonte me një balancë pozitive prej 429.619 lekësh sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr. 4**

<b>Analiza përfundimtare e treguesve financiarë për periudhën shtator 1991 – 16.3.2002</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat nga punësimi i subjektit në Prokurorinë e Rrethit Krujë, periudha shtator 1991 – shtator 1997	1009953
Të ardhurat nga punësimi i subjektit në Gjykatën e Rrethit Krujë, periudha tetor 1997 – 16.3.2002	2159634
Të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit si p. policie në DVP-në Durrës, periudha shkurt 1993 – 15.11.1997	598831
Të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Krujë, periudha nëntor 1997 – maj 2000	919212
Të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Tropojë për periudhën maj 2000 – janar 2001	339305
Të ardhurat neto nga shitja e apartamentit në Krujë në vitin 1999	1461480
Të ardhurat hua, deklaruar marrë nga vëllezërit e subjektit në vitin 2002	0
Të ardhurat nga pensioni i babait të bashkëshortit për periudhën qershor 1995 – shtator 1999	185720
Të ardhurat nga pensioni i nënës së bashkëshortit për periudhën qershor 1995 – shtator 1999	185540
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>6859675</b>
Shpenzime për pagesë të këstit të apartamentit nga subjekti në datën 16.3.2002	2023021
Shpenzim për pagesë të këstit të apartamentit nga bashkëshorti në datën 6.8.2001, 20.000 USD	2878000
Shpenzime minimale për konsum sipas jurisprudencës së Kolegjit, për periudhën 1991 – 1999	1087247
Shpenzime minimale për konsum sipas ILDKPKI-së, periudha 2000 – 16.3.2002, për 2 persona	441788
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>6430056</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>429.619</b>

**11.69** Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet financiare të pagimit të kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 2002, sipas parashikimeve të kontratës së shitblerjes dhe mandatit përkatës, duke provuar mundësinë financiare të saj dhe personit të lidhur, që me të ardhura të ligjshme të mundësonte pagimin e këstit në datën 16.3.2002, në shumën 14.300 USD, për këtë pasuri të paluajtshme.

*Lidhur me pagesën e kryer në vitin 2004*

**11.70** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pamundësinë financiare në vitin 2004, arsyeton se:

**11.71** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 pakësim të gjendjes *cash* gjatë vitit 2004 në shumën 3.000.000 lekë, për pagesën referuar mandateve kryer gjatë vitit 2004 në favor të shoqërisë ndërtuese. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pamundësinë financiare të krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar në dhjetor të vitit 2003, arsyeton si vijon:

**11.72** Edhe pas kalimit të rezultateve të hetimit referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues dhe të dokumentojë pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e vëllezërve të saj për dhënien e shumës prej 2.000.000 lekësh në mars të vitit 2002. Informacioni i plotë i shoqëruar me dokumentacion ligjor provues në formën e kërkuar nga ligji, për pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e huadhënësve fillon pas datës së deklaruar si dhënie e huas.

**11.72.1** Trupi gjykues vlerëson se dispozitat ligjore të nenit 32, pikat 2, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për pamundësinë objektive të sigurimit të informacionit të kërkuar, nuk gjejnë zbatim në rastin konkret.

**11.73** Pas marrjes në konsideratë në analizën financiare përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur vetëm të vlerës 1.500.000 lekë, sipas arsytimit të mësipërm, analiza financiare përfundimtare e treguesve financiarë për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003, për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar do të rezultonte sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 5**

<b>Analiza përfundimtare financiare për mundësinë e krijimit të gjendjes <i>cash</i> të deklaruar e krijuar në periudhën shtator 1991 – 31.12.2003</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto punësimit subjekti në Prok. Krujë për periudhën 9.1991 – 9.1997	1009953
Të ardhurat neto nga punësimi subjekti në Gjykatën e Rrethit Krujë për periudhën 10.1997 – 31.12.2003	3268859
Të ardhurat nga punësimi bashkëshortit si P. Policie Durrës për periudhën 2.1993 – 15.11.1997	598831
Të ardhurat nga punësimi bashkëshortit si OPGJ, Prok. Krujë për periudhën 11.1997 – 5.2000	919212
Të ardhurat nga punësimi bashkëshortit si OPGJ, Prok. Tropojë për periudhën 5.2000 – 1.2001	339305
Të ardhura neto nga shitja e apartamentit në Krujë në vitin 1999	1461480
Të ardhura, hua deklaruar marrë nga vëllezërit e subjektit në vitin 2002	0
Kthim i shumës 20.000 USD në datën 1.10.2002, nga anulimi i kontratës së datës 6.8.2001	2769600
Të ardhura nga pensioni i babait të bashkëshortit për periudhën qershor 1995 – shtator 1999	185720
Të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortit për periudhën qershor 1995 – shtator 1999	185540
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>10738500</b>
Shpenzim për pagesë të këstit të apartamentit në datë 16.03.2002 sipas mandatit përkatës	2023021
Shpenzim për pagesë të këstit të apartamentit nga bashkëshorti në datën 6.8.2001 në shumën 20.000 USD	2878000
<b>Shpenzime për punime shtesë të kryera nga subjekti në datën 14.5.2003, për ap. me sip. 136,7 m<sup>2</sup> sipas shkresës nga shoqëria ndërtuese</b>	600000
Shpenzime arredim/mobilim/pajisje elektroshtëpiake të deklaruara	40000
Shpenzime minimale për konsum sipas jurisprudencës së Kolegjit për periudhën 1991 – 1999	1087247
Shpenzime minimale për konsum sipas ILDKPKI-së për periudhën 2000 – 2003, për 2 persona	779384
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>7407652</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	-5000000
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-1.669.152</b>

**11.74** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë likuiditetin e deklaruar për periudhën shtator 1991 – 31 dhjetor 2003, duke rezultuar me balancë negative në vlerën -1.669.152 lekë për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti në fund të vitit 2003.

**11.75** Trupi gjykues vlerëson se likuiditeti që duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të vitit 2004 është vetëm vlera e gjendjes *cash* e provuar lidhur me ligjshmërinë, konkluzion i mbështetur në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit.

**11.76** Komisioni vlerësoi se burimi i deklaruar nga subjekti për shlyerjen e shumës 3.000.000 lekë në vitin 2004 referon në pakësimin e gjendjeve *cash* të deklaruara në fund të vitit 2003, për të cilat u arrit të dokumentohej nga subjekti ligjshmëria e burimit të tyre vetëm për vlerën 3.330.848 lekë (5.000.000 lekë – 1.669.152 lekë).

**11.77** Për rrjedhojë, vetëm vlera 3.330.848 lekë, e provuar për sa i përket ligjshmërisë së saj do të merret në konsideratë në analizën financiare përfundimtare, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit për pagesën e shumës 3.000.000 lekë shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara në vitin 2004.

**11.78** Për sa më sipër arsyetuar, analiza përfundimtare e subjektit të rivlerësimit për vitin 2004, për kryerjen e pagesave shoqërisë ndërtuese do të rezultonte sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 6**

<b>Analiza përfundimtare e treguesve financiarë viti 2004</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit për periudhën	878986
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit për periudhën	621926
Të ardhurat nga zbatimi i vendimit nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	1048798
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>2549710</b>
Shpenzim për pagesë shoqërisë ndërtuese	3000000
Shpenzim pagesë për blerje garazhi, shuma 10.000 euro, në datën 25.11.2004	1263500
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	151620
Shpenzime udhëtimi/transport i brendshëm (deklaruar në pyetësorin nr. 2), llogaritur	100320
Shpenzime minimale për konsum sipas ILDKPKI-së për periudhën, 2 persona	187928
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>4703368</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	2620950
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>467.292</b>

**11.79** Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për krijim të pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2004.

*Lidhur me pagesën për shoqërinë ndërtuese në vitin 2005*

**11.80** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pamundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit për pagesën e shumës 10.000 USD shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe pagesën e çmimit të vlerësuar të blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara në vitin 2005, arsyeton se:

**11.81** Subjekti pretendoi në analizën financiare për vitin 2005 të pasqyrohet dhe evidentohet që nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. është kthyer shuma 600.000 lekë, punime të kryera nga subjekti e bashkëshorti në vitin 2003 dhe të përfshira si shpenzime në analizën e kryer nga vetë Komisioni për periudhën deri në fund të vitit 2003.

**11.82** Në referim të tabelës nr. 5 të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se qëndron pretendimi i subjektit pasi rezulton se Komisioni në këtë tabelë financiare ka përfshirë vlerën 600.000 lekë si vlerë e investimeve të kryera nga subjekti e emërtuar “Shpenzime për punime shtesë të kryera nga subjekti në datën 14.5.2003, për ap. me sip. 136,7 m<sup>2</sup> sipas shkresës nga shoqëria ndërtuese”.

**11.83** Në analizë të deklarimit periodik të vitit 2005 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kthimin e vlerës 600.000 lekë nga shoqëria ndërtuese.

**11.84** Trupi gjykues, në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, i ka njohur vlerën e provës deklarates së pasurisë së vitit 2005, si e dhënë që vërteton pretendimet e subjektit në proces dhe duke e çmuar atë me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli.

**11.85** Në arsyetimin sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vlera 600.000 lekë, e shpenzuar prej vetë subjektit e bashkëshortit në datën 14.5.2003 dhe e përfshirë në analizën financiare të subjektit deri në vitin 2003 sipas tabelës nr. 5 në këtë vendim, duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur si vlerë e kthyer nga shoqëria ndërtuese në vitin 2005.

**11.86** Për sa më sipër arsyetuar, analiza përfundimtare e subjektit të rivlerësimit për vitin 2005 duke përfshirë vetëm të ardhurat, shpenzimet, si dhe ngjarjet financiare të periudhës, sipas tabelës në vijim do të rezultonte sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 7**

<b>Analiza përfundimtare e treguesve financiarë për vitin 2005</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit për periudhën	996584
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit për periudhën	654593
Të ardhurat nga kthimi i shumës 600.000 lekë, investime bërë nga subjekti në vitin 2003	<b>600.000</b>
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>2.251.177</b>
Shpenzim për pagesë shoqërisë ndërtuese	1035800
Shpenzim për blerje automjeti tip “****”, llogaritur	418750
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	147096
Shpenzime udhëtimi/transport i brendshëm (deklaruar në pyetësoin nr. 2), llogaritur	62700
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën, 2 persona	219114
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>1.883.460</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-482785
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-115.068</b>

**11.87** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerje pasurie, shtesë në likuiditet të deklaruar dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2005, duke rezultuar me një balancë negative për vitin në vlerën -115.068 lekë.

## **12. Garazh me sipërfaqe totale 22.0 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë**

**12.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë pasuri të krijuar në vitin 2004 sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.11.2004, duke u përpiluar kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.11.2011. Vlera: 10.000 euro.

**12.2** Në deklarinimin e interesave periodikë privatë për vitin 2004, bashkëshorti i subjektit në deklarinim të tij si OPGJ, ndër të tjera, ka deklaruar pasurinë garazh, i ndodhur në katin nëntokë të pallatit ku banon, në vlerën 10.000 euro, blerë me deklaratën noteriale datë 25.11.2004.

**12.3** Në procesverbalin e datës 15.1.2015 të mbajtur pranë ILDKPKI-së, në përgjigje të pyetjes nr. 3 në lidhje me kontratën e shitblerjes dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti deklaron: *“Kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti në shumën 10.000 euro. Sipërfaqja 37.6 m<sup>2</sup> përfshin edhe hyrjen në garazh. Sipërfaqja është sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.11.2011. Burimi i blerjes është shuma e përfituar me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 27.12.2002, nga bashkëshorti, në shumën 1.148.555 lekë. Ky vendim është ekzekutuar me mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 26.10.2004”*.

**12.4** Në bazë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 25.11.2004, shtetasja I. K. ka deklaruar se: *“I ka shitur z. A. H. një garazh me nr. \*\*\* (sipas projektit), me sip. 37.6 m<sup>2</sup>, të ndodhur në katin nëntokësor në godinën 11 kate të ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., sot me nënshkrimin e deklaratës më ka likuiduar tërësisht shumën e blerjes së garazhit në vlerën 10.000 euro”*.

**12.5** Me kontratën e shitjes nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 9.11.2011, shitësja I. K. i ka shitur bashkëshortit të subjektit një garazh me nr. \*\*\*/\*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, me sip. 22 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 1.617.000 lekë, shumë e cila është paguar jashtë zyrës noteriale (blerësi deklaron se e ka likuiduar çmimin e shitjes së pronës sipas deklaratës noteriale datë 25.11.2004).

### ***Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave dhe mundësia financiare***

**12.6** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 27.12.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ekzekutuar në datën 26.10.2004, bazuar në vërtetimin nr. \*\*\*, datë 28.1.2011, të lëshuar nga Drejtoria e Policisë, qarku Lezhë, ku është përfituar shuma neto prej 1.048.798 lekësh, si dhe nga kursimet familjare, të ardhurat nga pagat, shpërblimet nga puna dhe orët jashtë orarit. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, konstaton se shuma e përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor është tërhequr nga personi i lidhur disa ditë përpara se të kryhej pagesa e blerjes së garazhit. Burimi i deklaruar për blerjen është i dokumentuar.

**12.7** Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave të ligjshme për krijim e kësaj pasurie të paluajtshme dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara për periudhën.

### **13. Automjet tip “\*\*\*\*”, blerë në datën 15.2.2007**

**13.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë automjet, të blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.2007, në vlerën 500.000 lekë, me pjesë takuese 50%. Si burim krijimi ka deklaruar: kursimet familjare, pagat, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 1994.

**13.2** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me kontratën noteriale të datës 15.2.2007 është blerë automjeti tip “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*, vit prodhimi 1998, në shumën 500.000 lekë. Gjithashtu, me kontratën datë 7.11.2007 është shitur automjeti tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\*, në shumën 400.000 lekë.

**13.3** Referuar të dhënave nga DPSHTRR-ja rezulton se me kontratë shitblerjeje datë 15.2.2007 personi i lidhur dhe subjekti kanë blerë nga shtetasi Xh. H. automjetin tip “\*\*\*\*” kundrejt çmimit 500.000 lekë, shumë e parapaguar e gjitha jashtë zyrës noteriale.

**13.4** Gjithashtu, në përgjigjen nga ky institucion është bashkëlidhur edhe deklarata e shitjes nga shtetasi italian për shtetasin Xh. H. në datën 2.2.2007, në shumën 3.100 euro, si dhe vërtetimi për shlyerje të detyrimeve doganore me deklaratën nr. \*\*\*, datë 12.2.2007, nga shtetasi Xh. H., në shumën 267.272 lekë. Sa më sipër për këtë automjet, nga shtetasi Xh. H.



janë shpenzuar rreth 653.470 lekë (3.100 euro\*124.58 lekë/euro) + 267.272 lekë, pa shpenzime të transportit.

**13.5** Nisur nga fakti që shpenzimet për blerjen dhe zhdoganimin e këtij mjeti nga shitësi kanë qenë në vlerën 653.470 lekë dhe pas 3 ditësh subjekti dhe personi i lidhur blejnë këtë mjet në shumën 500.000 lekë, ku në kontratë është specifikuar se “*Blerësi e ka marrë në dorëzim mjetin, e ka vënë në provë dhe se nuk ka pretendim për gjendjen teknike*”, Komisioni vlerësoi në analizën financiare shumën 653.470 lekë si shumë e blerjes së mjetit nga subjekti dhe personi i lidhur.

#### ***Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave dhe mundësia financiare***

**13.6** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e këtij automjeti kursimet familjare, pagat, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “\*\*\*”, vit prodhimi 1994, shitur në shumën 400.000 lekë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.11.2007.

**13.7** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim të të ardhurave për blerjen e automjetit tip “\*\*\*”.

#### ***Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “\*\*\*” në shumën 400.000 lekë***

**13.8** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me kontratën datë 7.11.2007 është shitur automjeti tip “\*\*\*” në shumën 400.000 lekë.

**13.9** Në parashikimet e kontratës së shitblerjes së automjetit më sipër nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 7.11.2007, u përcaktua se palët janë likuiduar në mes tyre për këtë shumë në zyrën e noterisë në prani të noterit dhe se nuk kanë asnjë detyrim.

**13.10** Sa më sipër, trupi gjykues ka vlerësuar se shuma 400.000 lekë referuar kontratës është marrë në datën 7.11.2007 nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit tip “\*\*\*”, në datën 15.2.2007.

**13.11** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se: “*Në datën 6.12.2006 kam depozituar në Raiffeisen Bank shumën 9.000 euro, me burim kursime ndër vite. Nga kjo shumë e depozituar kam tërhequr 8.000 euro në datën 13.2.2007. Në datën 15.2.2007, kur kam blerë autoveturën e markës “\*\*\*” në shumën 500.000 lekë, këtë shumë e kam marrë nga shuma 8.000 euro, e tërhequr në Raiffeisen Bank më 13.2.2007.*

*Me shitjen e automjetit tip “\*\*\*” në datën 7.11.2007, në shumën 400.000 lekë, kjo shumë (pra 400.000 lekë) i është bashkuar tepricës (mbetjes) së shumës prej 8.000 euro dhe është deklaruar si gjendje cash, kursime në banesë në vitin 2007”.*

#### ***Në lidhje me burimin e deklaruar kursime familjare***

**13.12** Në DPV-në e vitit 2007, subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk kanë deklaruar burim të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

**13.13** Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank rezulton se në datën 13.2.2007 subjekti ka tërhequr *cash* nga llogaria depozitë në emër të saj, në euro, shumën 8.000 euro, ndërsa nga llogaria e saj në lekë në të njëjtën ditë shumën 100.000 lekë.

**13.14** Në lidhje me shumën 8.000 euro, që deklarohet si burim për blerjen e automjetit tip “\*\*\*” në datën 15.2.2007, nga dokumentacioni bankar rezulton se kjo shumë e ka prejardhjen nga depozita në shumën 9.000 euro, krijuar në datën 6.12.2006, për të cilën subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 2 ka deklaruar se e ka burimin nga kursimet ndër vite.

**13.15** Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e krijimit nga subjekti dhe personi i lidhur të depozitës prej 9.000 euro në datën 6.12.2006, duke përfshirë vetëm të ardhurat, shpenzimet, si dhe ngjarjet financiare të periudhës, sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 8**

<b>Analiza financiare dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ për vitin 2006</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit për periudhën	869461
Të ardhurat nga përfitim sigurime sipas Raiffeisen Bank	37238
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit për periudhën	563195
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>1469894</b>
Kthim huaje për vëllezërit, deklaruar	0
Shpenzime udhëtimi/transport i brendshëm (deklaruar në pyetësor), bashkëshorti	49200
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	0
Shpenzime minimale për konsum sipas ILDKPKI-së për periudhën, 2 dhe 3 persona	296554
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>345754</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-1311223
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-187.083</b>

**13.16** Sa më sipër, duket se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për depozitën në shumën 9.000 euro, krijuar në datën 6.12.2006, në llogarinë në emër të subjektit në Raiffeisen Bank dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1.1.2006 – 6.12.2006, duke rezultuar me balancë negative prej -187.083 lekësh dhe në gjithë vitin 2006 rezultoi pamundësia financiare në vlerën -112.709 lekë.

**13.17** Nisur nga fakti që subjekti nuk ka arritur të dokumentojë paraprakisht ligjshmërinë e krijimit të depozitës në Raiffeisen Bank në euro, të cilën e ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit, kjo depozitë e tërhequr në vitin 2007 nuk është përfshirë në analizën financiare për periudhën 1.1.2007 – 15.2.2007.

**13.17.1** Komisioni vlerësoi të kryejë analizën e financiare dërguar subjektit me rezultatet e hetimit për periudhën 1.1.2007 – 15.2.2007, nga e cila duket se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për periudhën 1.1.2007 – 15.2.2007, për blerjen e automjetit tip “\*\*\*” dhe kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me një balancë negative prej -456.475 lekësh.

**13.18** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të mësipërm të Komisionit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**13.19** Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se *lidhur me mundësinë e krijimit të depozitës në vitin 2006, e tërhequr në vitin 2007 dhe e përdorur si burim krijimi i pasurisë automjet tip “\*\*\*”, nga ana juaj është ndërtuar një analizë financiare, ku ka rezultuar me një diferencë negative në shumën -187.093 lekë.*

**13.9.1** Pra, depozita sipas pasqyrit nga ana e Komisionit në shumën 9.000 euro nuk mund të krijohej për këtë diferencë 187.083 lekë, e konvertuar me kursin e euros të vitit = 1.510 euro), çka nënkupton që për pjesën tjetër të depozitës duhet të rezultojnë me burim të justifikuar. Nga konstatimi dhe verifikimi i dokumentacionit bankar konfirmohet tërheqja bankare e depozitës dy ditë përpara blerjes së automjetit. Për këtë arsye, subjekti deklaroi se mendon që kjo analizë financiare nuk ka kuptim, për sa kohë që në analizën e kryer financiare për depozitën e krijuar janë të justifikuar 7.490 euro (9.000 euro – diferencën e pajustificuar 1.510 = 7.490 euro)”.’

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**13.20** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyeton si vijon:

**13.21** Mbështetur në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se qëndron pretendimi i subjektit mbi marrjen në konsideratë të llogarisë bankare të tërhequr në vitin 2007, e cila rezultoi e provuar për sa i përket ligjshmërisë në vlerën 7.490 euro dhe u tërhoq disa ditë para blerjes së kësaj pasurie të luajtshme, qëndron.

**13.22** Marrja në konsideratë e gjendjes në llogarinë bankare të tërhequr në vitin 2007, e provuar për sa i përket ligjshmërisë në vlerën 7.490 euro në analizën përfundimtare financiare të kryer, konsiderohet nga trupi gjykues se provon burimin e ligjshëm për pagesën e automjetit dy ditë pas tërheqjes së depozitës.

**13.23** Trupi gjykues vlerëson se analiza përfundimtare financiare e kryer për gjithë vitin 2006 për subjektin dhe personi i lidhur për dokumentimin e burimit të të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve ka rezultuar në pamundësinë financiare përfundimtare në vlerën -112.709 lekë, vlerë kjo e pranuar edhe nga vetë subjekti në analizën financiare dhe shpjegimet e sjella pas kalimit të barrës së provës.

## **14. Llogaria “\*\*\*\*” në lekë në emër të vajzës së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank**

**14.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë llogari depozitë (llogari kursimi për fëmijë) pranë Intesa Sanpaolo Albania Bank, hapur më 18.6.2007, që administrohet nga prindërit (subjekti dhe bashkëshorti), në pjesë takuese 50%.

**14.2** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit në të dhënat konfidenciale ka deklaruar: “...kontratë për llogarinë e kursimeve për fëmijën në vlerën 1.000.000 lekë, në Bankën Amerikane”.

**14.3** Referuar të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank rezulton se kjo llogari është hapur në datën 18.6.2007, me një depozitim *cash* nga subjekti i rivlerësimit të shumës 1.000.000 lekë, me përshkrimin “*Cash* depozit Ardiana Bera”.

**14.4** Në datën 29.12.2010 është shtuar shuma 100.000 lekë, në datën 4.1.2012 është shtuar shuma 100.000 lekë dhe në datën 10.6.2016 është depozituar *cash* shuma 300.000 lekë, me përshkrimin “Dhuratë për ditëlindje 10 vjeç nga familjarët, miqtë dhe prindërit”.

### ***Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite***

**14.5** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite *dhurata nga familjarët e subjektit dhe bashkëshortit të subjektit, miqtë, me rastin e lindjes së fëmijës K. H. dhe me rastet e ditëlindjes së saj; nga kursimet familjare, nga pagat në vite.*

**14.6** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për këtë depozitë “Dhuratën e deklaruar në vitin 2006”.

**14.7** Në DPV-në e vitit 2006 ka deklaruar se nga detyrimi ndaj vëllezërve, i deklaruar në vitin 2003, në shumën 2 milionë lekë, ishte shlyer vetëm 1 milion lekë, ndërsa shuma 1 milion lekë iu bë dhuratë me rastin e lindjes së fëmijës në janar të vitit 2006.

**14.8** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 22.8.2019, në të cilën vëllezërit M. dhe I. B. kanë deklaruar se: “Vlerën prej 1.000.000 lekësh

ia kemi dhuruar së bashku me prindërit tanë mbesës tonë, shtetases K. A. H., me rastin e lindjes së saj”.

**14.9** Nga analiza e kryer më lart lidhur me huan e marrë nga vëllezërit e subjektit trupi gjykues arriti në konkluzionin se ky burim ishte i paprovuar për sa i përket burimit të ligjshëm e, për pasojë, edhe burimi i deklaruar, shuma 1.000.000 lekë, nga kjo hua e cila shërbeu për krijimin e depozitës në emër të vajzës së subjektit, mbeti e paprovuar për sa i përket burimit të ligjshëm.

**14.10** Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, kreu një analizë financiare për periudhën 16.2.2007 – 18.6.2007, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e depozitës në emër të vajzës në datën 18.6.2007, në shumën 1.000.000 lekë, në Intesa Sanpaolo Bank, si dhe kryerjen e shpenzimeve të periudhës, sipas tabelës në vijim.

**Tabela nr. 9**

<b>Analiza e dërguar subjektit me rezultatet e hetimit për treguesit financiarë për periudhën 16.2.2007 – 18.6.2007</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit, dokumentuar për periudhën	365119
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit për periudhën	220529
Të ardhurat nga interesat	186
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>585648</b>
Shpenzime udhëtimi/transport i brendshëm (deklaruar në pyetësor), bashkëshorti	17800
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	0
Shpenzime minimale për konsum sipas ILDKPKI-së për periudhën	126461
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>144261</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-1145745
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>-704.358</b>

**14.11** Nga analiza financiare e mësipërme dërguar subjektit me rezultatet e hetimit, duket se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për krijimin e depozitës në emër të vajzës dhe shpenzimet për periudhën 16.2.2007 – 18.6.2007.

**14.12** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**14.13** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se mundësia e krijimit të depozitës së vajzës ekziston edhe pa përfshirjen e dhuratës së vëllezërve.

**14.14** Subjekti ka kërkuar korrigjimin e të dhënave lidhur me ndryshimin e likuiditeteve në bankë për këtë vit, të cilat pretendon se nuk janë llogaritur saktë në analizën financiare dhe korrigjimin e faktit se analiza financiare e bërë për depozitën e vajzës shpëput edhe të ardhurat e siguruara gjatë muajit janar dhe gjendjen *cash* në banesë në fillim të këtij viti, si dhe mundësinë e plotësimit të kësaj gjendjeje gjatë të njëjtit vit.

**14.15** Nëse analiza financiare përfshin gjendjen *cash* të deklaruar në fillim të vitit 2007, të disponueshme për kryerjen e kësaj pagese, deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006, rezulton më se e mjaftueshme, madje me diferencë të konsiderueshme mundësia për të kryer depozitën në shumën 1.000.000 lekë.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**14.16** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore – arsyetohet si vijon:

**14.17** Sipas arsyetimit në këtë vendim lidhur me të ardhurat e marra hua nga vëllezërit e subjektit, për të cilat trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues dhe të dokumentojë pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e vëllezërve të saj për dhënien e shumës 2.000.000 lekë në mars të vitit 2002, ato nuk mund të konsiderohen si burim krijimi për këtë depozitë në emër të vajzës së subjektit.

**14.18** Trupi gjykues vlerëson e pretendimet e subjektit mbi saktësimin e ndryshimit të likuiditeteve në bankë dhe mbi përdorim e gjendjes *cash*, të disponueshme për t'u përdorur e plotësuar nga subjekti brenda të njëjtit vit deklarimi, qëndrojnë dhe duhet të merren në konsideratë duke arritur të provojnë burimin e të ardhurave të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e depozitës në emrin e vajzës, në datën 18.6.2007.

**14.19** Trupi gjykues ka vlerësuar në arritjen e këtij përfundimi edhe sa ka rezultuar lidhur me shumën 400.000 lekë nga shitja e automjetit në vitin 2007, e cila referuar kontratës është marrë në datën 7.11.2007 dhe nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, në datën 15.2.2007, por si e ardhur e krijuar në vitin 2007 brenda të njëjtit vit ka shërbyer për plotësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në këtë vit.

**14.20** Nisur nga fakti që në deklaratën e interesave private për vitin 2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” me kontratën e datës 15.2.2007, dhe krijimin e llogarisë “\*\*\*\*” në lekë, në emër të vajzës, hapur më 18.6.2007, Komisioni ka vlerësuar edhe kryerjen e një analize përfundimtare financiare gjithëpërfshirëse mbi gjithë pasuritë e krijuara dhe shpenzimet nga subjekti dhe personi i lidhur për vitin 2007, vit i cili ka rezultuar me pamundësi financiare në rezultatet e hetimit, dërguar subjektit me barrën e provës.

**14.21** Nga analiza financiare e kryer pas marrjes në konsideratë të depozitës së tërhequr në vitin 2007, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerje pasurie, shtesë në likuiditet të deklaruar dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2007, duke rezultuar me një balancë negative përfundimtare për vitin 2007 në vlerën -377.480 lekë, sipas tabelës si vijon.

**Tabela nr. 10**

<b>Analiza përfundimtare e e treguesve financiarë për vitin 2007</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhura neto nga paga e subjektit të rivlerësimit	1.094.657
Të ardhura neto nga paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit	680.746
Të ardhura nga interesa depozite në emër të subjektit të rivlerësimit në monedhën euro, në Raiffeisen Bank	3.644
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>1.779.047</b>
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën	369.264
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	158.314
Shpenzime udhëtim/transport të brendshëm (deklaruar në pyetësor) bashkëshorti	52.800
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>580.378</b>
Automjet ***, vit prodhimi 1994 ,në vlerë 300.000 lekë , kontratë datë 21.3.2005, shitur me kontratë datë 7.11.2007	-400.000
Automjet ***, me targë ***, blerë me kontratë datë 15.2.2007, në shumën 500.000 lekë	653.470
Likuiditete (ndryshim gjendje, shtesa/pakësime)	1.322.768
<b>Total Asete</b>	<b>1.576.238</b>
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-377.569</b>

## 15. Depozitë 12-mujore në emër të subjektit në Credins Bank, në vlerën 592.370 lekë

15.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë depozitë në emër të saj në Credins Bank, në vlerën 592.370 lekë, të hapur në datën 30.9.2011 dhe shtuar në datën 2.10.2012, me burim: kursime familjare, pagat, shpërblime nga puna, orë pune jashtë orari (të deklaruara).

15.2 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit, në ndryshim të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ka deklaruar ndër të tjera edhe llogari bankare në emër të saj në Credins Bank në shumën 400.000 lekë, depozituar në datën 30.9.2011, me transferim nga llogaria e bashkëshortit.

15.3 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit, në ndryshim të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ka deklaruar: "...shtuar llogari bankare me afat në emër të subjektit në Credins Bank, në shumën 100.000 lekë...".

15.4 Gjithashtu, në DPV-në e viteve 2014 – 2016, subjekti ka deklaruar interesat e përfituar nga kjo llogari depozitë.

15.5 Referuar informacionit nga Credins Bank, me shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021, rezulton se në datën 30.9.2011 është transferuar në llogari të subjektit shuma 400.000 lekë nga bashkëshorti dhe në të njëjtën ditë kjo shumë kalon në depozitë me afat 12-mujor.

15.6 Për sa i përket shumës së transferuar prej 400.000 lekësh, ajo ka qenë e akumuluar në llogarinë e pagës së personit të lidhur në Credins Bank, ndërsa në datën 2.10.2012 subjekti ka kaluar në depozitë edhe shumën 100.000 lekë.

### *Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite*

15.7 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj depozite: kursime familjare, pagat, shpërblime nga puna dhe orë pune jashtë orari.

15.8 Në deklaratimet periodike vjetore 2011 dhe 2012 nuk është deklaruar burim për krijimin dhe shtimin e kësaj depozite.

15.9 Sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2011 – 30.9.2011, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e depozitës në shumën 400.000 lekë, në datën 30.9.2011.

**Tabela nr. 11**

<b>Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2011 – 30.9.2011</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit subjekti, dokumentuar për periudhën	779926
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit bashkëshortit për periudhën	960511
Të ardhura interesa llogaria e depozitës, vajza	79318
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>1819755</b>
Shpenzime shkollimi	81600
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	250074
Shpenzime minimale për konsum sipas ILDKPKI-së për periudhën	292328
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>624002</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-487592
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>708161</b>

**15.10** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj depozite në datën 30.9.2011, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën.

## **16. Depozitë dyemërore në BKT, në emër të subjektit/bashkëshortit**

**16.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë depozitë dyemërore në BKT, hapur në datën 9.9.2016, në vlerën 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

**16.2** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar ndër të tjera depozitën me afat në BKT, në lekë, në emër të saj dhe bashkëshortit, hapur në datën 9.9.2016, në shumën 1.000.000 lekë.

**16.3** Referuar të dhënave nga BKT-ja, rezulton se në datën 9.9.2016 është depozituar *cash* në llogarinë dyemërore Ardiana Beraj ose A. H. shuma prej 1.000.000 lekësh, me përshkrimin “Ardiana Beraj sa derdhur në llog. tërhequr nga RZB”, ndërsa në datën 13.9.2016 ka kaluar në depozitë me afat e njëjta shumë.

**16.4** Në bazë të të dhënave nga Raiffeisen Bank rezulton se nga llogaria në lekë në emër të subjektit në këtë bankë është tërhequr në datën 29.1.2016 shuma 572.386 lekë, ndërsa nga llogaria në euro në emër të subjektit në datën 29.1.2016 është tërhequr shuma 1.057.67 euro.

### ***Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave dhe mundësia financiare***

**16.5** Si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite tërheqjen në datën 29.1.2016 të depozitave plus interesat pranë Raiffeisen Bank, depozita të krijuara në vitin 2010 nga subjekti dhe bashkëshorti, të deklaruara në vitin 2011, si dhe nga tërheqja e llogarisë plus interesat pranë Raiffeisen Bank të shumës 1057.67 euro, tërhequr në datën 29.1.2016, deklaruar në vitin 2008. Nga tërheqja e depozitës plus interesa, e hapur në vitin 2010, deklaruar në vitin 2011 në emër të bashkëshortit të subjektit, tërhequr në datën 25.9.2015, deklaruar tërheqja në vitin 2016; depozita të krijuara nga kursimet familjare, paga, punë jashtë orarit, shpërblime për punën e kryer.

**16.6** Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank rezulton se:

- Nga llogaria në lekë në emër të subjektit në këtë bankë është tërhequr në datën 29.1.2016 shuma 572.386 lekë. Kjo shumë është formuar nga depozita me afat e datës 29.12.2010 në shumën 500.000 lekë, e krijuar nga llogaria e pagës dhe interesa të akumuluar deri në janar të vitit 2016.

- Nga llogaria në euro në emër të subjektit në datën 29.1.2016 është tërhequr shuma 1.057.67 euro, e cila ka qenë gjendje në këtë llogari.

- Në llogarinë në lekë në emër të personit të lidhur në datën 8.11.2010 është krijuar depozita me afat në shumën 300.000 lekë, me kursime të ardhura nga llogaria e pagës. Kjo depozitë është rikthyer në llogari rrjedhëse në datën 8.11.2011 dhe në datën 25.9.2015 është tërhequr nga bashkëshorti i subjektit shuma 315.500 lekë.

**16.7** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, në deklarim të interesave privatë të personit të lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar tërheqje të llogarisë në emër të tij në shumën 315.500 lekë, deklaruar në vitin 2011.

**16.8** Komisioni, si krijimin e depozitave, ashtu edhe ecuritë e tyre, i ka pasqyruar në analizën paraprake të viteve përkatëse, ndërsa për sa i përket shumës 315.500 lekë, të tërhequr *cash* nga llogaria e bashkëshortit në datën 25.9.2015, referuar DIPP-së së vitit 2015, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar: “*Kursime për vitin 2015 nga pagat neto, për deklaruesin dhe bashkëshortin e saj në shumën 910.000 lekë*”.

## **Depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, dyemërore në emër të subjektit/bashkëshortit**

**16.9** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë depozitë dyemërore në Intesa Sanpaolo Bank, hapur në datën 21.10.2016, në vlerën 2.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

**16.10** Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar ndër të tjera depozitën në lekë në Intesa Sanpaolo Bank, në emër të saj dhe bashkëshortit, e hapur në datën 21.10.2016, në shumën 2.500.000 lekë.

**16.11** Referuar të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank, rezulton se në datën 21.10.2016 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë depozituar *cash* shumën 2.500.000 lekë, me përshkrimin “Depozitim në llogari nga pagat ndër vite të deklaruara në ILDKPKI vit pas viti”. Në të njëjtën ditë shuma ka kaluar në depozitë me afat në këtë bankë.

#### ***Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave dhe mundësia financiare***

**16.12** Si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite kursimet nga pagat, shpërblimet për punën e kryer, orë pune jashtë orari të subjektit dhe bashkëshortit (të deklaruara në vite).

**16.13** Referuar analizës së bërë edhe më sipër në lidhje me kursimet *cash*, të deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike vjetore, konkretisht në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: “*Kursimet nga pagat në vitet e punës, gjithsej 1.500.000 lekë dhe 11.000 euro*”.

**16.14** Në DPV-në e vitit 2008 deri në DPV-në e vitit 2013, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim/shtesë/pakësim apo gjendje të likuiditeteve *cash*.

**16.15** Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar shumën 870.000 lekë si kursim për vitin 2014 nga pagat për deklaruesin dhe bashkëshortin (në banesë, ndërsa në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar shumën 910.000 lekë si kursime për vitin 2015) nga pagat neto për deklaruesin dhe bashkëshortin e saj.

**16.16** Shuma e likuiditeteve *cash* të akumuluar në banesë në datën 31.12.2015, sipas deklaratimit të subjektit do të rezultonin në 3.280.000 lekë dhe 11.000 euro.

**16.17** Në DPV-në e vitit 2016 është deklaruar: “*Depozitë në lekë në ISP, hapur në datën 21.10.2016, në vlerën 2.500.000 lekë, me burim kursimet ndër vite*”. Gjithashtu, edhe në lidhje me depozitën e krijuar në shtator të vitit 2016 në BKT, në shumën 1.000.000 lekë, subjekti ka deklaruar si burim nga kursimet e deklaruara në DPV-në e vitit 2015.

**16.18** Ndërsa, për sa i përket shumave të deklaruara të kursyera për vitet 2014 dhe 2015, përkatësisht në vlerat 870.000 lekë dhe 910.000 lekë, subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijimin e tyre.

**16.19** Sa më sipër, nga Komisioni u krye një analizë paraprake financiare për periudhën 1.1.2016 – 21.10.2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e depozitës së përbashkët në shumën 1.000.000 lekë në datën 9.9.2016, në BKT, ashtu edhe depozitës në shumën 2.500.000 lekë në datën 21.10.2016, në Intesa Sanpaolo Bank, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë, konkretisht si në vijim.

**Tabela nr. 12**

<b>Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2016 – 21.10.2016</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lek</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit, dokumentuar për periudhën	1100270
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit për periudhën	1332610
Të ardhura interesa llog. subjekti, Credins Bank për periudhën	10395
Të ardhura interesa llog. dep. vajza, në ISP (mars 2016)	33712



<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>2476987</b>
Shpenzime shkollimi fëmije	232800
Shpenzime për telefon (në Credins Bank), subjekti	13642
Shpenzim për sigurime, automjeti	15860
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	66263
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën	531904
<b>Total shpenzime/të dala financiare</b>	<b>860469</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	1780000
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-3108360
<b>Mjete monetare të disponueshme</b>	<b>288.158</b>

**16.20** Sa më sipër, trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës së përbashkët në shumën 1.000.000 lekë në datën 9.9.2016, në BKT, ashtu edhe depozitës në shumën 2.500.000 lekë në datën 21.10.2016, në Intesa Sanpaolo Bank, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë.

### **17. Llogari rrjedhëse në Credins Bank e subjektit dhe bashkëshortit, në vlerën 927.689 lekë**

**17.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse në Credins Bank, me burim krijimi nga kursimet nga pagat, orë pune jashtë orari, në vlerën 927.689 lekë. Pjesa takuese: 50%.

**17.2** Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse, gjendje gjithsej në Credins Bank për subjektin dhe bashkëshortin në shumën 681.779 lekë, me burim kursime nga pagat, orë pune jashtë orari.

**17.3** Referuar të dhënave nga Credins Bank, rezulton se gjendja në llogarinë në lekë (rrjedhëse të pagës) në emër të subjektit në datën 31.12.2016 rezulton në vlerën 347.067 lekë, ndërsa në llogarinë rrjedhëse të pagës së personit të lidhur në këtë datë rezulton në shumën 334.712 lekë.

**17.4** Në llogari të subjektit, gjendja në datën 20.1.2017 rezulton në vlerën 457.552 lekë, ndërsa për bashkëshortin në vlerën 470.137 lekë, në total 927.689 lekë. Subjekti ka bashkuar gjendjet në llogaritë përkatëse të pagës së saj dhe të bashkëshortit në Credins Bank.

**17.5** Si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite kursimet nga pagat, orë pune jashtë orari të subjektit dhe bashkëshortit.

**17.6** Referuar dokumentacionit bankar, këto llogari janë hapur në vitin 2010, si për subjektin ashtu edhe për personin e lidhur, në të cilat janë kredituar të ardhurat periodike nga paga.

**17.7** Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur, për krijimin dhe shtimin e këtyre gjendjeve në llogaritë rrjedhëse të pagës, trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijimin e llogarive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën.

### **18. Gjetje të tjera**

**18.1** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: “Nga tetori 1999 deri në vitin 2003 kam qëndruar tek banesa e prindërve së bashku me bashkëshortin, në cilësinë e mbajtësit të thjeshtë (pa të drejta reale), që buron nga marrëdhëniet familjare, pasi prindërit e bashkëshortit dhe bashkëshorti shitën banesën e tyre me kontratën e datës 13.9.1999 (duke u larguar nga banesa në tetor 1999, sipas shënimeve në kontratën e shitjes). Për shkak të marrëdhënieve të posaçme nuk kam paguar qira. Prindërit e mi jetonin vetëm në qytetin e Krujës, me adresë Lagjja Nr. \*\*, pasi dy vëllezërit e mi jetonin jashtë shtetit, në Angli...”.

**18.2** Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me ndërtimin e kësaj banese në qytetin e Krutës dhe burimin e të ardhurave për krijimin e pasurisë, të cilën e ka përdorur, dhe, në përfundim të hetimit të kryer, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm që nuk ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

### **Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**19.** Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj.

**19.1** Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitin 2005 në vlerën -115.068 lekë, për vitin 2006 në vlerën -112.709 lekë dhe për vitin 2007 në vlerën -337.489 lekë, për gjithë periudhën e deklaramit nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera.

**19.2** Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, mospërputhjet e reflektuara në dokumentacionin ligjor të përfitimit të pasurisë apartament si pasaktësi në veprimin e ligjshëm që passjell disponimin e kësaj pasurie nga subjekti dhe pamundësia financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit 2003, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

**19.3** Komisioni, pas hetimit të kryer bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 lidhur me kriterin e pasurisë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**20.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës, i deklasifikuar plotësisht për subjektin e rivlerësimit Ardiana Bera.

**20.1** Bazuar në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Ardiana M. Bera nuk administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari të paligjshme.

### **Konkluzioni i Komisionit për kontrollin e figurës**

**20.2** Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**20.3** Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**20.4** Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në konkluzionin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**21.** Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreut VI, neneve 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor.

**21.1** Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është bazuar në formularin e vetëdeklarimit bashkë me dokumentet shoqëruese, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**21.2** Lidhur me tri dosjet e përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar problematika.

**21.3** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtaren Ardiana Bera përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

## **22. ANALIZA E GJETJEVE**

### **Aftësitë profesionale**

#### *Njohuritë ligjore*

**22.1** Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Konstatohet se gjyqtarja manifeston njohuritë e duhura në drejtim të cilësimit juridik të veprës penale dhe respekton kriteret e nenit 47 të Kodit Penal në caktimin e llojit të masës së dënimit ndaj të pandehurit kur provohet fajësia e tij. Gjyqtarja nuk ngurron të japë pafajësi në rastet kur nuk provohen elementet e veprës penale. Në të drejtën penale njeh dhe zbaton alternativat e dënimit me burgim. Në të drejtën procedurale penale, subjekti i rivlerësimit respekton të drejtën e të pandehurit për të pasur avokat mbrojtës në gjykim, si në rastin kur ai e ka zgjedhur vetë një të tillë apo edhe kur kërkohet nga ky i fundit dhe nuk ka mundësi ekonomike ta paguajë, duke i caktuar kryesisht një mbrojtës. Njeh dhe zbaton gjykimin e shkurtuar sipas parashikimit të nenit 404 të Kodit të Procedurës Penale. Kur është rasti, përdor edhe referenca në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese apo edhe të Gjykatës së Lartë. Po në të drejtën procedurale, gjyqtarja njeh dhe zbaton shuarjen e masave të sigurimit, duke respektuar të drejtat legjitime të të pandehurve.

#### *Arsyetimi ligjor*

**22.2** Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të arsyetimit të vendimeve të dhëna prej saj dhe që kanë qenë objekt vëzhgimi për efekt të rivlerësimit kalimtar. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta e të kuptueshme. Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësi interpretimit dhe analizës së normës ligjore të zbatueshme në çështjet konkrete që ka pasur për gjykim. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

## **Aftësitë organizative**

### *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

**22.3** Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo ka deklaruar se gjatë periudhës 8.10.2013 – 8.10.2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 1347 çështje, ku ka përfunduar 1145 prej tyre e duke mbartur në vitin 2017 gjithsej 50 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 85.7%. Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se gjyqtarja Ardiana Bera gjatë periudhës së rivlerësimit ka punuar vetëm në Dhomën Penale.

**22.4** Referuar nenit 3, shkronja “a” e Aneksit 1, gjyqtari i Dhomës Penale si relator duhet të gjykojë jo më pak se 100 gjykime penale (krime + kundërvajtje penale). Si rezultat, për tri vite duhet të gjykojë jo më pak se 300 çështje penale (krime + kundërvajtje). Ndërkohë, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit për tri vite ka përfunduar së gjykuari 633 çështje penale. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe tejkaluar standardin sasior të përcaktuar në Sistemin e Vlerësimit.

**22.5** Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë deri në 4 muaj e 1 ditë. Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 15 ditë, 3 muaj e 4 ditë dhe 1 muaj e 10 ditë. Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se në të gjitha rastet është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit.

**22.6** Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Ardiana Bera në 4 raste ka respektuar afatet ligjore. Konkretisht, arsytimi i vendimeve është kryer për 3 ditë nga shpallja, për 4 ditë nga shpallja, për 2 ditë nga shpallja (shihni dosjet 3 e 4) dhe për 7 ditë nga shpallja. Vetëm në dosjen nr. 5, afati ligjor i arsytimit të vendimit është tejkaluar me dy ditë, shkelje e cila nuk vlerësohet si domethënëse.

### *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

**22.7** Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara.

### *Aftësia për të administruar dosjet*

**22.8** Nga vëzhgimi i dosjeve gjyqësore nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje ka vendim formal për caktimin e seancës gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, kërkesa për gjykim bashkë me fashikullin hetimor në dosjet penale, vendimet për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore apo seancë pajtimi, fletëthirrjet, vendimi përfundimtar, ankimi dhe vendimi i gjykatës më të lartë etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale.

## **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### *Etika në punë*

**22.9** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Ardiana Bera përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### *Integriteti*

**22.10** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### *Paanësia*

**22.11** Nga dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera. Gjithashtu, në dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i

gjuhës diskriminuuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *Aftësitë e komunikimit*

**22.12** Në dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

#### *Aftësia për të bashkëpunuar*

**22.13** Në dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. Nuk janë evidentuar raste të shpeshta, që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore apo në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

#### *Gatishmëria për t'u angazhuar*

**22.14** Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 18 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë edhe në trajnime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

### **Konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale**

**22.15** Trupi gjykues arrin në konkluzionin se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **DENONCIMET**

**23.** Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u analizuan denoncimet për subjektin e rivlerësimit.

**23.1 Denoncim i shtetasit Dh. N., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2019.** Denoncuesi kallëzon shumë subjekte rivlerësimi, midis tyre edhe gjyqtaren Ardiana Bera. Denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë vendim të padrejtë në kundërshtim me ligjin procedural penal. Denoncuesi në vitin 2009 ka bërë një kallëzim penal ndaj disa drejtuesve të ish-uzinës “Partizani” dhe disa noterëve dhe ekspertëve për veprat penale “Shpërdorimi i kompetencave”, “Abuzim me detyrën”, “Shpërdorimi i detyrës”, etj. Ky kallëzim është depozituar pranë kimit ekonomik dhe financiar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, e cila i ka sugjeruar prokurorit P. H. ta kalojë këtë çështje në gjykatë. Prokurori ka pushuar çështjen dhe denoncuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë me ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes, me arsyetimin se ishin zhdukur materialet hetimore në dosjen penale. Zhdukja e këtyre materialeve hetimore u justifikua nga ana e gjyqtarës Ardiana Bera me dhënien e vendimit nr. \*\*\* akti, datë 23.9.2011. Në fletën e fundit të këtij vendimi, para se të shprehej në dispozitivin e këtij vendimi, ajo shprehet se pretendimet e kërkuesit për moskryerjen e veprimeve hetimore janë të parëndësishme dhe nuk sjellin asnjë pasojë në përfundimin e procedimit penal.

Denoncuesi ka depozituar pranë Komisionit dosjen e çështjes në të cilën ndodhen disa vendime gjykatash si: vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë; vendim për mospranim rekursi nga Gjykata e Lartë; urdhër për regjistrim kufizimi nga ZVRPP-ja Tiranë; urdhra të tjerë, nxjerrë nga ZVRPP-ja Tiranë; kontrata sipërmarrjeje; vendime të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në dosje ndodhet edhe vendimi nr. \*\*\* akti, datë 23.9.2011, i dhënë nga subjekti, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit M. N. për prishjen e vendimit datë 15.10.2010 “Për

pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2009” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me argumentimin se: Nga aktet e administruara në fashikullin e këtij procedimi penal rezultoi e provuar se Prokuroria ka realizuar një hetim të plotë, të gjithanshëm dhe objektiv për verifikimin e pretendimeve të kallëzuar nga kallëzuesit, të cilët bëjnë fjalë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim ankuesi Dh. N. dhe Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.4.2012, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\* akti, datë 23.9.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Komisioni, pasi mori në analizë këtë denoncim, arrin në përfundimin se vendimmarrja e subjektit dhe hapat proceduralë të ndjekur, që kanë çuar në këtë vendimmarrje, janë në përputhje me ligjin, duke u konfirmuar si të tilla edhe nga gjykatat më të larta me vendimmarrjet përkatëse.

**23.2 Denoncim i shtetasit T. K., i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2018.** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit zhvillon proces gjyqësor të njëanshëm, duke zhvilluar seanca në kundërshtim me ligjin, pa marrë parasysh asnjë provë dhe fakt të paraqitur nga denoncuesi. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur vendim të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmbush kriteret e nenit 53, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**23.3 Denoncim i shtetasit V. Q., i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2019.** Denoncuesi ankohet ndaj disa subjekteve, midis tyre edhe subjekti i rivlerësimit, për konsumim të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, për korrupsion sepse kanë dhënë vendime në favor të vjedhësve të pronës së tij. Denoncimit i ka bashkëlidhur disa vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendime të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në dosje ndodhet vendimi nr. \*\*\* akti, datë 17.12.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës penale me nr. \*\*\* akti, datë 15.10.2012, me objekt kundërshtimin e vendimit penal datë 10.7.2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, për arsye se kërkuesi kishte hequr dorë nga shqyrtimi i kërkesës, duke kërkuar pushimin e gjykimit. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2013, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\* akti, datë 17.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Komisioni, pasi mori në analizë këtë denoncim, arrin në përfundimin se vendimmarrja e subjektit dhe hapat proceduralë të ndjekur, që kanë çuar në këtë vendimmarrje, janë në përputhje me ligjin, duke u konfirmuar si të tilla edhe nga gjykatat më të larta me vendimmarrjet përkatëse.

**23.4 Denoncim i shtetasit A. Q., i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018.** Denoncuesi pretendon shkelje të Kodit Etik dhe moral nga ana e subjektit të rivlerësimit. Denoncimit i ka bashkëlidhur vendimin nr. \*\*\*, datë 17.12.2014, me kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të pandehur denoncuesin A. Q., akuzuar për veprën penale “Prishja e qetësisë publike”. Në përfundim, gjykata ka vendosur “Pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit A. Q.”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Komisioni, pasi mori në analizë këtë denoncim, arrin në përfundimin se vendimmarrja e subjektit dhe hapat proceduralë të ndjekur, që kanë çuar në këtë vendimmarrje, janë në përputhje me ligjin, duke u konfirmuar si të tilla edhe nga gjykatat më të larta me vendimmarrjet përkatëse.

**23.5 Denoncim i shtetasit V. Ç., i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019,** i cili denoncon shumë gjyqtarë dhe prokurorë për korrupsion dhe shpërdorim detyre. Bashkëlidhur denoncimit nuk ka asnjë dokument ligjor që të provojë pretendimet e tij. Në këto kushte, Komisioni çmon se denoncimi i këtij shtetasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

**23.6 Denoncim i shtetasit A. Z., i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2019.** Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë ryshfet në këmbim të pafajësisë për të pandehurit, njëri përmbarues dhe tjetri regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë. Të pandehurit në bashkëpunim kanë tjetërsuar pronën e denoncuesit dhe e kanë shitur nëpërmjet ankandëve fiktive. Si dokumentacion, denoncuesi ka bashkëlidhur vendimin e pafajësisë së të pandehurve, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2023, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vënë në dispozicion dosjen penale kundër të pandehurve B. N. dhe S. Sh., për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Nga dokumentacioni në dosje u konstatua se në bisedimet përfundimtare të çështjes prokurori kishte kërkuar deklarin fajtor të të pandehurve për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Nga CD-ja e seancave gjyqësore dhe dokumentacioni shkresor rezultoi se subjekti ka zbatuar drejt ligjin procedural dhe atë material, ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, ka thirrur dëshmitarët e kërkuar nga organi procedural penal dhe palë e pandehur. Ka analizuar dispozitat e ligjit material mbi regjistrimin e pasurive, dispozita e Kodit të Procedurës Civile mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile dhe procedurat e ankandit dhe, në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka shpallur të pafajshëm të pandehurit B. N. dhe S. Sh.

Në arsyetimin e saj gjykata ka çmuar se në veprimet e të pandehurit B. N. nuk ka asnjë element të dashjes për të kryer veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në dëm të shtetasit H. Z. apo NBG Bank, për të siguruar përfitime të padrejta për vete apo persona të tjerë. Në bazë të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, propozimi për regjistrimin e urdhrin përmbarimor nuk vjen në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore apo nënligjore dhe është një proces, që përfundon me nënshkrimin dhe vulosjen e regjistruarit të ZVRPP-së Tiranë dhe jo të specialistit S. Sh.

Procesi i regjistrimit të pronës nuk ka sjellë asnjë pasojë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për ndonjë subjekt lidhur me të drejta reale të pronësisë apo të barrës hipotekore. Kundër vendimit nr. \*\*\* , datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur pafajësi për të pandehurit B. N. dhe S. Sh., ka bërë ankim organi i akuzës, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe deklarin fajtor të të pandehurve për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”.

Në konkluzionet e datës 27.10.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka kërkuar se lidhur me vendimin nr. \*\*\* , datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i drejtë dhe i bazuar në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi dhe, për këtë arsye, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë heq dorë nga ankimi ndaj vendimit nr. \*\*\* , datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. \*\*\* , datë 27.10.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur “Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr. \*\*\* , datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Komisioni nuk konstatoi shkelje ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, pasi mori në analizë këtë denoncim, arrin në përfundimin se vendimmarrja e subjektit dhe hapat proceduralë të ndjekur, që kanë çuar në këtë vendimmarrje, janë në përputhje me ligjin, duke u konfirmuar si të tilla edhe nga gjykatat më të larta me vendimmarrjet përkatëse.

**23.7 Denoncimet e shtetasit K. D., të regjistruara me nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2023, nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2023, nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2021, nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2023.** Ky shtetas ka kallëzuar disa subjekte rivlerësimi dhe punonjësin e IT-së së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Denoncimi i tij është një kallëzim penal drejtuar organit procedural penal. në lidhje me konsumimin e veprave penale si “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, drejtuar disa subjekteve.

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

**23.8 Denoncim i shtetasit N. M., i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2019,** i cili pretendon shkelje të procesit të rregullt nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nga studimi i dokumentacionit u vërejt se subjekti ka shfuqizuar vendimin e pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2014, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i lënë detyrë organit të akuzës për të kryer akt ekspertimi të ri kompjuterik, duke thirrur ekspert specialist të fushës kompjuterike për të zbardhur vazhdimin e transkriptimit të bisedave të përmbajtjes së skedarëve audio në CD, objekt ekspertimi të ekspertimit të mëparshëm. Subjekti i rivlerësimit ka pranuar kërkesën e kërkueses. Nga studimi i dokumentacionit vërehet se vendimmarrja e subjektit është e drejtë dhe shkon në drejtim të zbardhjes së të vërtetës në lidhje me pretendimet e palëve.

Komisioni nuk gjeti *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**23.9 Denoncim i shtetasit V. M., i regjistruar me nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë 9.7.2021.** Denoncuesi ankohet ndaj subjektit dhe disa shtetasve të tjerë. Nga verifikimi i dokumentacionit, Komisioni ka konstatuar se denoncuesi ka një konflikt pasurie me dy ish-bashkëpronarët e tjerë të një prone të ndodhur në qytetin e Durrësit. Pas kallëzimit penal që ka bërë, prokurori i Durrësit ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”, me arsyetimin se çështja ishte e natyrës civile. Ky vendim i prokurorit është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\* regj., datë 7.6.2019. Në bazë të kallëzimit penal nr. \*\*\*, viti 20019, të kryer nga shtetasi V. M. në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim i Prokurorisë së Rrethit Tiranë është ankimuar nga shtetasi V. M. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin e datës 3.3.2020 ka vendosur “Mospranimin (Pushimin) e kërkesës së paraqitur nga ankuesi V. M., për shkak se përfaqësuesja e ankuesit hoqi dorë nga kërkesa për gjykim”.

Komisioni nuk gjeti *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**23.10 Denoncim i shtetasit E. T., i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2019.** Denoncuesja kërkon nga Komisioni që të verifikojë dosjen penale, me të pandehur shtetasin A. D., gjithashtu kërkon të verifikojë shkakun e daljes para kohe të datës së seancës më 17.3.2022. Komisioni, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nuk ka kompetencë të shqyrtojë kërkesat e palëve në procesin gjyqësor, pasi janë jashtë objektit të veprimtarisë së tij.

**23.11 Denoncimet e av. J. K., të regjistruara me nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2023.** Kjo denoncuese ankohet për shkelje të ligjit procedural, për sjellje jo të mirë të subjektit me palët, konfirmon faktin që çështja vazhdon. Ka depozituar pranë Komisionit një kërkesë që i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Penale) për dijëni disa institucioneve, midis tyre edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga përmbajtja e kërkesës Komisioni konstaton se nuk merr në shqyrtim kërkesat e palëve në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në gjykatën kompetente, pasi kjo kompetencë për të vlerësuar kërkesat procedurale të palëve dhe vendimmarrjen mbi ligjshmërinë e tyre i takon një gjykate më të lartë.

**23.12 Komisioni, referuar burimeve të hapura në media** lidhur me dy çështje të cilat kanë marrë vëmendjen e opinionit publik [https://\\*\\*\\*.com/\\*\\*\\* \\*\\*\\*/\\*\\*\\*](https://***.com/*** ***/***) i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**i) Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 13.6.2022**



Shtetasja Diana Kolaveri është dënuar me vendimin nr. \*\*\*/\*\*/2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (nga një tjetër trup gjykues) ku është vendosur “Deklarimi fajtor i të pandehurës D. H. K., për veprën penale “Braktisja e fëmijëve të mitur” të parashikuar nga neni 124/1 i Kodit Penal dhe dënimit e saj me 250.000 lekë gjobë”. Në zbatim të nenit 34 të Kodit Penal, gjoba do të likuidohet me marrjen formë të prerë të vendimit. Në bazë të këtij vendimi, viktimë e veprës penale është shtetasi B. K., përfaqësues ligjor i fëmijës së mitur I. K., i datëlindjes 14.10.2016, ku në kohën e kryerjes së veprës penale fëmija ka qenë bebe 8-muajshe. Vendimi nr. \*\*\*/\*\*/2020 ka marrë formë të prerë në datën 17.9.2020, pa u ankimuar nga palët.

Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë me objekt “Konvertimi i dënimit me gjobë, dhënë ndaj të dënuarës D. K., për shkak mosshlyerjen e gjobës”, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga unë, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. \*\*\*/\*\*/2022, datë 13.6.2022, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Zëvendësimi i dënimit me gjobë prej 250.000 lekësh ndaj të dënuarës D. K. me vendimin e formës së prerë nr. \*\*\*/\*\*/2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me burgim”. Ngarkohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi dhe kryerjen e përllogaritjeve sipas kërkesave të nenit 34/9 të Kodit Penal. Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 15.8.2022. Kam respektuar më përpikëri rregullat procedurale për njoftimin e të dënuarës D. K. (H.), bazuar në adresën e dhënë nga ana e përfaqësuesit të akuzës, por edhe në adresën e përcaktuar në vendimin nr. \*\*\*/\*\*/2020, datë 18.6.2020. E dënuara është njoftuar me fletëthirrjen datë 3.12.2021, fletëthirrje e kthyer nga shërbimi postar me shënimin “Larguar”. E dënuara është njoftuar nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore në vendbanimin e saj. Komisariati i Policisë Mat, me shkresën nr. \*\*\*/\*\*/2022, datë 13.1.2022, konfirmon se shtetasja D. K. (H.) nuk është gjendur në banesë dhe nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, por edhe nga deklaratimet e babait të saj, rezultoi se kjo shtetase është larguar jashtë territorit të Shqipërisë. Sipas të dhënave të sistemit TIMS, e dënuara ishte larguar jashtë shtetit në datën 27.2.2021 dhe nuk kishte hyrje në territorin shqiptar pas kësaj date. Gjykata ka njoftuar të dënuarën nëpërmjet njoftimit me shpallje në Bashkinë Mat, në faqen zyrtare të Gjykatës. Me shkresën nr. \*\*\*/\*\*/2022, Bashkia Mat ka njoftuar Gjykatën se në datën 3.2.2022, pranë vendeve të afishimit të Bashkisë/Njësisë Administrative Burrel është bërë afishimi për efekt njoftimi të shtetases D. K.

Pas këtyre veprimeve procedurale, gjykata ka deklaruar mungesën e së dënuarës D. K., duke i caktuar avokat mbrojtës kryesisht, në mungesë të saj. Me marrjen formë të prerë të vendimit, në datën 15.8.2022, nga ana e prokurorit është ndjekur procedura e ekzekutimit, i cili është ekzekutuar në datën 7.3.2023, rreth shtatë muaj pasi vendimi kishte marrë formë të prerë.

Gjykata nuk kishte asnjë të dhënë apo indicie që shtetasja D. K. të ishte kthyer nga jashtë shtetit, duke kryer një martesë tjetër në një qytet tjetër, në Shkodër (me vendbanim \*\*\*/\*\*/2022, \*\*\*/\*\*/2022, Shkodër), duke marrë mbiemrin “B.” dhe nga kjo martesë kishte lindur fëmija N. B., i datëlindjes 25.2.2023. Në datën 17.3.2023, shtetasja D. B. (K.) ka paraqitur për gjykim kërkesën penale nr. \*\*\*/\*\*/2023 regjistri themeltar me objekt “Rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kundër vendimit penal nr. \*\*\*/\*\*/2022 akti, datë 13.6.2022 (i dhënë nga ana ime). Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*/\*\*/2023 regjistri themeltar, datë 3.4.2023, ka vendosur: Deklarimin e papranueshëm të kërkesës që i përket kërkueses D. B. me objekt rivendosje në afat...”. Aktualisht, vendimi nr. \*\*\*/\*\*/2023 regjistri themeltar, datë 13.6.2022, është i formës së prerë”.

## **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni, pasi administroi dosjen gjyqësore të çështjes së depozituar nga subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore, pas kryerjes së analizës, vëren se në dosje ndodhen aktet e njoftimit të së dënuarës sipas pretendimeve të subjektit, kërkesa e organit të procedurës penale për konvertimin e dënimit me gjobë me burg, vendimin e gjykatës të formës së prerë për dënimin me gjobë të shtetases D. K. për kryerjen e veprës penale “Braktisja e fëmijëve të

mitur”, procesverbalet e seancave gjyqësore, vendimi për konvertimin e dënimit me gjobë në burg. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm hapat proceduralë në lidhje me njoftimin e të dënuarës dhe kryerjen e veprimtarisë gjyqësore në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Sipas ligjit procedural penal, subjekti ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke respektuar të drejtat e palëve si e drejta për të marrë dijeni në lidhje me zhvillimin e një procesi gjyqësor, e drejta për t’u dëgjuar para një gjykate të paanshme, e drejta për t’u mbrojtur vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose kur nuk ka mundësi t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkon interesi i drejtësisë.

Trupi gjykues vlerëson se nuk ka shkelje të ligjit procedural penal nga ana e subjektit të rivlerësimit në gjykimin e kësaj çështjeje.

#### ***ii) Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë***

Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit, vlerëson se referuar burimeve të hapura në media Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë vendosi më 12.3.2024 për transferimin e kësaj çështjeje në SPAK, pasi Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi në nëntor të vitit 2023 se hetimet e papërfunduara kishin shkelur të drejtën e jetës së viktimave, duke mbajtur në konsideratë edhe vendimin nr. \*\*\*, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin thuhet se: “*Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore*”, arrin në përfundimin se për sa çështja është ende në gjykim në kuptim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të shtrihet vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë çështje.

#### **Konkluzioni i Komisionit lidhur me denoncimet**

**24.** Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e gjyqtarës.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ardiana Bera:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale;

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, nenit 58, shkronja “a” e pikës 1 dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ardiana Bera, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë më 26.4.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Xhensila PINE**  
**Relatore**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*